

Pyetje dhe përgjigje për rregulloren e mbrojtjes kundër corona-s duke filluar nga 22 Shkurti 2021

Cilat kufizime të kontakteve vazhdojnë të jenë në fuqi?

Deri ma 7 Mars do të jenë në fuqi kufizimet e mëposhtme të kontakteve: Takimet në hapësirën publike lejohen vetëm ndërmjet pjesëtarëve të një bashkësie jetese si dhe një person tjetër. Ky person mund të shoqërohet nga fëmijë që kanë nevojë për përkujdesje nga bashkësia e jetesës tuaj; në kuadrin e aplikimit të të drejtave të sjelljes, edhe prindi që jeton i ndarë mund të shoqërohet nga fëmijët që kanë nevojë për shoqërim. Përrjashtimet e deritanishme për distancën minimale vazhdojnë të mbeten në fuqi të pandryshuara dhe gjenden në § 2 pika 2 e rregullores për mbrojtjen kundër corona-s. Të përjashtuar nga këto rregulla janë ndër të tjera fëmijët që luajnë në këndin e lodrave për fëmijë, përdorimi i transportit publik (aty duhet të mbahen maska mjekësore) ose shoqërimi dhe monitorimi i adoleshentëve dhe personave i personave që kanë nevojë për mbështetje. Edhe përdorimi i shërbimeve vullnetare ose komunale të transportit për shembull rrugës për në qendrat e vaksinimit paraqet një përjashtim në raport me rregulloren për mbrojtjen kundër corona-s.

Çfarë vlen në lidhje me detyrimin për mbajtjen e maskës?

Në vende të caktuar vazhdon të jetë në fuqi detyrimi për mbajtjen e një maske mjekësore. Maskat mjekësore në kuadrin e rregullores për mbrojtjen kundër corona-s janë të ashtuquajturat maska OP të normës EN 14683 (duhet të jetë e deklaruar mbi paketimin në të cilin shitet) ose masa të standardit KN95/N95 ose FFP2 dhe maska të një standardi më të lartë – por përkatësisht pa valvul për nxjerrjen e ajrit. Detyrimi për mbajtjen e një maske mjekësore ekziston pavarësisht nga respektimi i distancës minimale

- në dyqanet e shitjes me pakicë, farmaci, pika karburanti, banka etj. si dhe në klinikat mjekësore dhe në institucione të tjera ngjashme mjekësore,
- në transportin publik – edhe në stacione trenash dhe stacione autobusësh
- gjatë përdorimit të shërbimeve vullnetare dhe komunale të udhëtimit për shembull rrugës për te qendrat e vaksinimit
- në rastin e eventeve ku duhet të jeni i pranishëm ose eventeve arsimore dhe provimeve në përputhje me § 6 dhe 7 të rregullores për mbrojtjen kundër corona-s
- gjatë shërbimeve fetare dhe grumbullimeve të tjera për ushtrimin e fesë edhe kur jeni i ulur.

Detyrimi i mbajtjes së një maske mjekësore ekziston gjithashtu edhe për marrjen ose ofrimin e mundshëm të shërbimeve të floktoreve duke filluar nga data 1 Mars 2021. Bazuar në ligjin federal (rregullorja e mbrojtjes në punë SARS-CoV-2- e Ministrisë Federale për Punën dhe Çështjet Sociale të datës 21 Janar 2021) edhe në vendin e punës ekziston detyrimi i mbajtjes së një maske mjekësore, atje ku nuk ruhet distanca prej 1,5 metrash. Në këtë rast duhet që punëdhënësi të vendosë në dispozicion maskat mjekësore. Detyrimi i mbajtjes së maskës (të paktën një maskë normale) vazhdon të jetë në fuqi sidomos në sektorët e mëposhtëm, ndërkohë që këtu vazhdon të jetë e mjaftueshme mbajtja e një maske normale:

- në ambiente të mbyllura në hapësira publike, për sa kohë ato – me ose pa kontroll në hyrje – ato janë të aksesueshme edhe nga kliente dhe klientë ose vizitore dhe vizitorë,

- në tregje dhe në qendra të ngjashme shitje në ambient të jashtëm,
- në të gjithë sipërfaqe e dyqaneve të shitjes me pakicë dhe në parkingjet përkatëse si dhe në rrugët e hyrjes në një distancë prej dhjetë metrash nga hyrja e dyqanit.

Çfarë vlen te fëmijët në lidhje me detyrimin për mbajtjen e maskës?

Vazhdon të jetë në fuqi rregulli, që fëmijët deri në moshën për fillimin e shkollës janë të përjashtuar nga detyrimi për mbajtjen e maskës. Nëse fëmijëve nën 14 vjeç nuk i përshtatet siç duhet një maskë mjekësore, mjafton një maskë normale edhe në vende të tjera, në të cilat maska mjekësore është e detyrueshme.

Çfarë vlen në lidhje me detyrimin për mbajtjen e maskës në institucionet e kujdesit ditor të fëmijëve dhe shkolla?

- Në shkolla është në fuqi detyrimi për mbajtjen e një maske mjekësore, ndërkohë që fëmijët deri në klasën e 8-të mund të mbajnë edhe një maskë normale, nëse maskat mjekësore nuk i përshtaten (ende).
- Në qendrat ditore të kujdesit të fëmijëve detyrimi i mbajtjes së maskës (që do të thotë maskë mjekësore) vlen vetëm për të rriturit, dhe vetëm nëse ato nuk mund ta ruajnë distancën minimale ndërmjet tyre (pra ndërmjet të rriturve). Kjo vlen më pas edhe për prindërit sidomos gjatë sjelljes dhe marrjes.

Kur lejohen të hapen përsëri flokoret dhe qendrat e kujdesit podiatrik jo mjekësor? Çfarë vlen për shërbimet e tjera?

Duke filluar nga data 1 Mars lejohen të ofrohen dhe të merren përsëri shërbimet podiatrike dhe të flokoreve. Përkundër sfondit të rëndësisë së tyre për higjienën personale, në veçanti njerëzit e moshuar varen shumë nga këto shërbime pas një kohe kaq të gjatë. Objektet për shërbimet e tjera të domosdoshme jo mjekësore, si qendrat kozmetike, qendrat për trajtimin e thonjve ose qendrat e tatuazheve ndërkohë do të qëndrojnë të mbyllura deri me 7 Mars, duke qenë se në rastin e tyre nuk ekzistojnë arsyet e veçanta të jashtëzakonshme.

Cila është gjendja në sektorin e gastronomisë dhe të hotelerisë?

Restorantet dhe baret do të vazhdojnë të qëndrojnë të mbyllura, kjo vlen gjithashtu edhe kantinat dhe mensat. Vetëm shërbimi i dërgimit dhe marrjes është i lejuar. Kantinat e ndërmarrjes dhe mensat në institucionet arsimore lejohet që të përdoren vetëm atëherë për furnizimin e të punësuarve ose të përdoruesve dhe përdoruesve të institucioneve arsimore, nëse nuk ekziston mundësi tjetër për ruajtjen e proceseve të punës ose të një funksionimi të lejuar të procesit arsimor.

Mundësitë e qëndrimit natën për qëllime private vazhdojnë të jenë të ndaluara. Nuk janë qëndrime private natën, qëndrimet natën për arsye pune/shërbimi.

A është e mbyllur tregtia me pakicë?

Po. Tregtia me pakicë mbetet e mbyllur deri me 7 Mars. Të përjashtuara nga kjo gjë janë: Ushqimoret, shërbimet e marrjes dhe dërgimit, tregjet e pijeve, tregjet ushqimore javore, farmacitë, dyqanet e ushqimeve të shëndetshme, dyqanet mjekësore, dyqanet e specializuar për foshnjat, dyqanet e artikujve të përzier, pikat e furnizimit me karburant, bankat, arkat e kursimit, qendrat postare, kioskat dhe pikat për shitjen e gazetave, tregjet për shitjen e ushqimit të kafshëve dhe tregjet për nevojat e kafshëve, tregtia me shumicë (për klientët e tregtisë me shumicë), ofrimi i produkteve ushqimore për institucionet sociale (qendrat e bamirësisë për ofrimin falas të vakteve).

Lejohen që të hapen tregjet e ndërtimit dhe të kopshteve ?

Përdorimi i tregjeve të ndërtimit dhe të kopshteve vazhdojnë që të jenë të lejuara vetëm për furnizimin e atyre që ushtrojnë biznes. Një përjashtim vlen për shitjen e luleve dhe bimëve në vazo që prishen shpejtë si dhe për fidanë perimesh dhe fara (fara, qepë, patate për tu mbjellë etj.): Këto mallra duke përfshirë edhe aksesorët lejohen që nga ana e tregjeve të ndërtimit dhe të kopshteve ti shiten edhe personave privat. Por tregjet e ndërtimit dhe të kopshteve duhet që shitjen te personat privat ta kufizojnë vetëm te këto mallra dhe nuk lejohen që të shesin produkte të tjera.

Çfarë vlen për shitjen e luleve, fidanëve të perimeve dhe farave?

Dyqanet e shitjes me pakicë, të cilat shesin lule të prera ose në vazo të cilat prishen shpejt si dhe aksesorë që lidhen me këtë gjë (vazo dhe produkte të tjera të ngjashme), janë lejuar që të qëndrojnë hapur deri më tani. Duke filluar nga 22 Shkurti këto dyqane lejohen të shesin edhe fidanë perimesh dhe fara.

Është e mundur tregtia duke e dërguar mallin dhe marrja e mallit nga klientët?

Po. Tregtia duke e dërguar mallin dhe dërgimi i mallrave të porositura vazhdon të jetë e lejuar. Marrja e mallrave të porositura nga ana e klientëve lejohet vetëm atëherë, nëse një gjë e tillë mund të kryhet duke respektuar masat mbrojtëse kundrejt infeksioneve.

Në cilat kushte është i mundur mësimi i muzikës?

Duke filluar nga 22 Shkurti vlen: Për fëmijët deri në moshën e shkollës fillore mësimi i muzikës duke qenë prezent si mësim i veçantë lejohet përsëri.

Mësimi i muzikës duke qenë prezent lejohet gjithashtu përsëri, nëse ai është integruar në paketën që ofrohet në qendrat ditore të kujdesit për fëmijët ose në shkollat e nivelit fillor ose në bashkëpunim me ato, vetëm për grupet fikse të fëmijëve të një shkolle të formuara në këto institucione ose të një mundësie të kujdesit ditor. Në kryerjen e këtyre aktiviteteve duhet që përdoren ambiente mundësisht të mëdha si dhe të përdoret sa më shumë të jetë e mundshme mundësitë e mësimi hibrid ose me turne.

Çfarë vlen për mundësitë e trajnimeve dhe arsimit të mëtejshëm?

Parimisht janë të ndaluara të gjitha mundësitë e trajtimeve dhe të arsimit të mëtejshëm duke përfshirë edhe mundësitë e kompensuara të arsimit bazë si dhe mundësitë, të cilat i shërbejnë integritimit, dhe provimet ndër të tjera edhe në qendrat e edukimit për të rriturit dhe institucionet e arsimit të mëtejshëm me sponsorizim tjetër si dhe mundësitë e vetë-ndihmës. Por të përjashtuar nga kjo ndalesë janë:

- Mësimet individuale ose masat e tjera të arsimit individual jashtë mjediseve të mbyllura,
- Mësime me prezencë për klasat e viteve të fundit të kurseve për diplomat me provim shteti në rrugën e dytë arsimore.
- Mësimi me prezencë për klasat e viteve të fundit për përgatitjen për një diplomë profesionale
- Provimet me prezencë që lidhen me përfundimin e një arsimit profesional ose të një shkolle dhe provimet, të cilat i shërbejnë integritimit, si dhe masat përgatitore për këtë gjë me prezencë, nëse ato nuk mund të transferohen për arsye ligjore ose faktike ose transferimi i personave që duhet të japin provimin nuk është i arsyeshëm.
- mundësitë arsimore jashtëshkollore me mbështetje publike për nxënës dhe nxënës në shkollat në sensin e § 1 rregullores së kujdesit gjatë kohës së corona-s, si dhe mundësitë bazuar në direktivën për nxitjen e mundësive arsimore dhe të kujdesit jashtëshkollor në kohët e corona-s për reduktimin e disavantazheve të shkaktuara nga pandemia.

Për këto përjashtime duhet që të respektohen me rreptësi masat e ruajtjes së distancës dhe të mbrojtjes. Përveç kësaj, në kryerjen e këtyre aktiviteteve duhet që përdoren ambiente mundësisht të mëdha si dhe mundësia e mësimit hibrid ose me turne.

Do të mbeten të hapura shkollat e larta dhe mundësitë jashtëshkollore të arsimit në shërbimin publik?

Regjimi mësimor dhe i provimeve në shkollat e larta dhe në shkollat e sektorit shëndetësor është i mundur duke respektuar detyrimet e ligjit për mbrojtjen kundër infeksioneve.

Në këtë rast, eventet mësimore lejohet që të miratohen vetëm atëherë me prezencë, nëse ato ose nuk mund të kryhen pa prezencë dhe ose nuk mund të shtyhen pa shkaktuar disavantazhe të rënda për studentët.

Provimet me prezencë dhe masat përgatitore për ato lejohen vetëm atëherë, nëse ato për arsye detyruese nuk mund të transferohen ose transferimi nuk është i arsyeshëm për personat që do të japin provimin.

Eventet e brendshme arsimore duke përfshirë edhe provimet që i përkasin atyre në kuadrin e shërbimeve përgatitore dhe arsimit, trajnimit dhe arsimit të mëtejshëm profesional në shkollat e larta, shkollat dhe institucionet e tjera të ngjashme që i shërbejnë arsimit, trajtimit dhe arsimit të mëtejshëm profesional në shërbimin publik, si dhe në gjykata dhe institucione shtetërore, duke qenë prezent janë në përgjithësi të ndaluara. Të përjashtuara nga ato janë mësimi me prezencë në vitin e fundit dhe në rastin e arsimit profesional që nuk zgjat disa vjet, në pjesën e fundit të arsimit pra provimit përfundimtar ose të karrierës. Në aktivitete të tilla duhet që të përdoren hapësira mundësisht të mëdha.

Ekziston detyrimi i Homeoffice?

Ministria Federale e Punës ka lëshuar një urdhëresë (Rregullorja për mbrojtjen në punë SARS-CoV-2 e Ministrisë Federale të Punës dhe Çështjeve Sociale e datës 21 Janar 2021), e cila parashikon që punëdhënësi duhet ti mundësojë Homeoffice të punësuarve të tij kudo që kjo gjë është e mundur. Në këtë mënyrë duhet që të reduktohen kontaktet në vendin e punës dhe rrugës për në punë. Rregullorja do të hyjë në fuqi së shpejti.

Çfarë vlen për sportin në kohën e lirë dhe atë amator?

Ushtrimi i sportit në kohën e lirë dhe atij amator, është i ndaluar në përgjithësi në të gjitha impiantet sportive publike dhe private, në palestra, pishina dhe mjedise të tjera të ngjashme.

Por duke filluar nga 22 Shkurti 2021 lejohet ushtrimi i sportit në mënyrë individuale, me dy persona ose vetëm me persona nga e njëjta bashkësi jetese në impiante sportive dhe në ambient të hapur duke përfshirë edhe mësimin e sportit si mësim individual. Kjo vlen për shembull për fusha sportive, impiante të atletikës së lehtë, fusha tenisi në mjedis të hapur ose fusha golfi. Ndërmjet personave të ndryshëm ose grupeve të ndryshme të personave, të cilët lejohen të ushtrjnë sport në të njëjtën kohë në impiante sportive në qiell të hapur, duhet që të respektohet një distancë minimale prej pesë metrash. Përdorimi i mjediseve të përbashkëta, duke përfshirë dhomat e zhveshjes dhe për të bërë dush, të impianteve sportive është e ndaluar.

Duke respektuar kufizimet e kontaktit vazhdojnë të jenë të lejuara edhe vrapimi, ecja dhe lloje të tjera sportesh jashtë impianteve sportive.

Çfarë ndodh me institucionet kulturore?

Koncertet dhe shfaqjet në teatro, salla operash ose koncertesh, kinema dhe mjedise të tjera publike dhe private (kulturore) janë të ndaluara deri me 7 Mars 2021. E njëjta gjë vlen edhe për përdorimin e muzeve, ekspozitave të artit, galerive, kështjellave, kalave, memorialëve dhe objekteve të tjera të ngjashme. Vetëm kinematë nga automjeti me një distancë minimale prej 1,5 metrash ndërmjet automjeteve lejohen që të operohen.

Çfarë rregullash vlejné për muzikantët profesionistë?

Kryerja e provave për ushtrimin e profesionit vazhdon të jetë e lejuar. Gjithashtu muzikantëve profesionistë i lejohet që të japin koncerte ose shfaqje pa publik për ti regjistruar ose për ti transmetuar në radio dhe internet.

Çfarë ndodh me qendrat për kalimin e kohës së lirë dhe qendrat e argëtimit?

Deri me 7 Mars 2021 ndalohet përdorimi i

- pishinave dhe pishinave argëtuese, salloneve për marrjen e rrezeve të diellit, saunave dhe termave dhe objekteve të tjera të ngjashme,

- Kopshteve zoologjike, parqeve të kafshëve, parqeve për kalimin e kohës së lirë, shesheve të brendshme të lojërave dhe objekteve të tjera të ngjashme për aktivitetet në kohën e lirë (brenda dhe jashtë),
- Sallave të lojërave, kazinove dhe objekteve të tjera të ngjashme
- Klubeve, diskotekave dhe objekteve të tjera të ngjashme
- Bordellove, objekteve të prostitucionit dhe objekteve të tjera të ngjashme
- Udhëtimeve për ekskursione me anije, karroca, trena historik dhe objekteve të tjera të ngjashme.

Në pika shitjesh të basteve sportive dhe pika bastesh vazhdohet të lejohet vetëm marrja e skedave të lojërave, e basteve etj.. Qëndrimi i mëtejshëm (për shembull për ndjekjen e ndeshjeve dhe eventeve, të cilave ju referohen bastet) është i ndaluar.

Lejohen ende eventet dhe grumbullimet?

Eventet dhe grumbullimet, të cilat i nënshtrohen rregullave të veçanta të rregullores për mbrojtjen kundër corona-s, janë të ndaluara deri me 7 Mars 2021. Të lejuara mbeten – duke respektuar kushtet përkatëse për çdo rast – ndër të tjera:

- Grumbullimet në përputhje me ligjin e grumbullimeve (p.sh. demonstrata).
- Eventet, të cilat i shërbejnë furnizimit bazë të popullatës, ruajtjes së sigurisë dhe rendit publik ose të shërbimeve publike ose të sigurisë (p.sh. takimet e partive për zgjedhjet ose dhurimi i gjakut)
- Takimet e organeve të përcaktuara me ligj për vetëqeverisjen lokale
- Takimet e organeve, shoqërive, partive, shoqatave ose shoqatave të pronarëve të banesave të përcaktuara me ligj, të cilat nuk mund të kryhen në mënyrë digjitale
- Varrime
- lidhjet e martesave